

## *Ndryshimet e gjirit?*

### Tani vlen: Vepra shpejt!

Në simpoziumin "SCHAUMANN", realizuar në vjeshtë 2013, në Austri, z. Olger Nanagjoka, menaxher shitjeje dhe konsulent në Austria-Prämix, përfaqësuese e përgjithshme e kompanisë SCHAUMANN për Shqipërinë dhe Kosovën, mbajti këtë referat.

**Sëmundja e gjirit** shkakton në mbarshkrimin e gjedhit për qumësht dëme të mëdha ekonomike. E njëjta gjë vlen dhe për fermat që kanë në ambjentin e tyre lopë në mëmëzim. Referati i mëposhtëm tregon se si duhet të reagojë fermeri në momentin kur ndeshet me këto sëmundje.

Kontrolloni së pari me përpikmëri të gjitha gjiret, për të konstatuar, cila pjesë e gjirit paraqet ndryshime në qumësht. Kryeni një shalm-test për të konstatuar nëse numri i qelizave somatike ka pësuar ndryshime.



Detajoni ndryshimet e qumështit, të tilla si: bërja e qumështit petë-petë, sekrecionet në formën e pudingut, sekrecionet me ngjyrë rozë, nëse qumështi ka njolla gjaku, sekrecione të lëngta të cilat anojnë në ngjyrë të verdhë, sekrecione si supa apo ndryshime të tjera.

Gjatë inspektimit të gjirit, vini re nëse gjiri është i nxehtë apo lopa reagon nga dhimbja, nëse një ose më shumë se 4 gjinj marrin ngjyrë të kuqe apo nxihen, dhe gjithashtu nëse janë të ngurtësuara apo të enjtura.

Masni temperaturën e brendshme të turpit të tyre, temperatura normale është 38 °C deri në 38,8 °C. Përcaktoni në vazhdimësi ndryshimet shëndetësore të lopës, (të ushyerin, të përtypurin, nëse qëndron shtrirë më shumë se zakonisht, diare).

#### **Referojuni mostrës së qumështit**

Mostrën e qumështit mund ta merrni vetë, në të kundërt këtë proces e kryen një veteriner. Një mostër duhet të merret në konsideratë për çdo ndryshim sekrecioni. Pas marrjes së mostrave të qumështit aseptik (pa mikroba), mund të dërgohen direkt në laboratorin hetues të qumështit ose

sipas nevojës të dërgohet në fundjavë e ngrirë në temperaturën -18 °C. Nga rezultati njoftoni veterinerin sipas të dhënave në vijim.

**Mjelja rozë** mund të shfaqet tek lopët menjëherë pas lindjes. Pavarësisht ndryshimit të ngjyrës së qumështit, nëse qumështi rrjedh gjatë mjeljes pa pengesa dhe nëse lopa nuk ndikohet nga shqetësime shëndetësore (si p.sh. temperatura, kollitja gjatë ngrënies), mund të merret parasysh se brenda në gjinj të saj shfaqen enë gjaku të vogla. Kjo shfaq gjak në qumësht dhe një njollë me ngjyrë tipike rozë. Në shumicën e rasteve ky problem zhduket vetvetiu pas disa ditësh. Sipas nevojës veterineri rekomandon vitaminë C dhe kalcium.

**Nëse ka gjak gjatë mjeljes** apo shtim të mpiksjes së gjakut mund të ndodhë një hemoragji masive në gji. Hemoragjia ndodh si pasojë e plasjes së enës së gjakut në gji, e shkaktuar nga goditje me brinj, lëndime në stallë, apo geni i gjakderdhjes në familjen e lopës. Për shkak të mpiksjes së gjakut, mund të shkaktohen pengesa të rrjedhjes së qumështit, sidomos në pjesën e kanalit të thithës. Duke përshkuar thithën me gishta mund të ndjejmë copëzat e gjakut gjatë kësaj prekjeje. Në gjakderdhjen e gradës së lartë gjoksi rritet në mënyrë të konsiderueshme për shkak të hematomave dhe lopa mund të tregojë shenja anemie. Nëse ka shenja gjaku apo mpiksje gjatë mjeljes duhet të telefononi gjithmonë veterinerin. Si masë në kuadrin e ndihmës së shpejtë mund t'i bëni gjirit një dush me ujë të ftohtë, duke qenë se e ftohta favorizon mbylljen e enëve.

Më pas për ndalimin e hemoragjisë duhet të ndaloher mjelja që të rezultojë mbyllja e përkohshme e gjirit nën mbrojtjen e antibiotikëve. Qumështi mund të derdhet me një kateter. Aplikimi i vitaminës C, kalciumit, infuzionit apo transfuzionit të gjakut, jepet me vlerësim të veterinerit në varësi të gjendjes së kafshës.

Pavarësisht gjendjes normale shëndetësore të lopës (temperatura e brendshme e trupit nën 38,8 °C, lopa ha dhe përtypet përsëri) ndërsa qumështi bëhet petë-petë, duhet marrë së pari një mostër qumështi. Menjëherë duhet një trajtim i pjesës përkatëse të gjirit. Nëse është prekur vetëm një nga këto katër gjinj (nuk ka ndryshime sekrecioni në pjesë të tjera, shalm testi është negativ), zakonisht mjafton një trajtim intermamar me injeksionin përkatës. Intervalet e trajtimit duhet të ndiqen siç i ka rekomanduar saktësisht veterineri (numri i injeksioneve). Nëse do të rekomandohet një ndalim i parakohshëm i antibiotikëve mund të krijohen mikroba rezistente (dmth. që në një përdorim të dytë të antibiotikut këto keqbërës bëhen imun) dhe mund të krijohen sëmundje kronike në gji.

Gjithashtu kafsha duhet të mjelet deri në pikën e fundit. Përmes terapisë, duhet të normalizohet sekrecioni i qumështit dhe të futen qelizat. Nëse nuk është rasti për të ndodhur kështu, mundet që pas rezultateve të mostrës së qumështit (antibiogram), të ndryshojë trajtimi.

### **Temperatura, shqetësime të përgjithshme**

Në rast se ndryshon temperatura e qumështit dhe gjendja normale e lopës duhet të lajmërohet menjëherë veterineri. Sidomos tek gjendrat mastite, shkaktuar nga mikrobet koliforme (sekrecione me ngjyrë të verdhë, ulja e prodhimit të qumështit, enjtje e gjirit) nëse nuk reagohe në kohë për shërimin e tyre mund të jenë dhe vdekjeprurëse. Më së shumti marrja e barnave bëhet direkt në ‘vena’ me një terapi intramamare. Antibiotikët, barnat inflamatore dhe infuzionet duhet të jepen sipas rekomandimit veterinar. Veçanërisht është shumë e rëndësishme përsëritja e shpeshtë e mjeljes për të zhdukur nga gjendra e qumështit bakteriet, toksinat dhe produktet inflamatore. Marrja e oksitocinës mund të ndihmojë.

### **Sekrecionet me aromë të keqe**

Aroma e sekrecionit në formën e “supës së bizeleve” është karakteristike e të ashtuquajturit “mastite verore”, shkaktuar nga bakteri Arcanbacterium pyogenes. Kjo formë e mastiteve shoqërohet me formimin e gjendrave në gji. Një rivendosje e patogjenit është e mundur me gjak në nyje, në mëlçi ose organe të tjera. Trajtimi me antibiotikë zakonisht nuk është i suksesshëm, pasi ata nuk mund të depërtojnë në ngacmues për shkak të akumulimit të qelbit.

Amputim i thithkës me shpërlarje të mëvonshëm të gjirit mund të sjellë një përmirësim në gjendjen e përgjithshme të lopës. Për shkak se patogjeni është shumë i përhapur, kryesisht nga mizat, lopa e sëmure përfaqëson një burim potencial infeksioni për kafshët e tjera.

### **Vepra shpejt**

Nëse gjiri apo qumështi pëson ndryshime, për nevojat urgjente është e domosdoshme të veprohet shpejt. Në shumicën e rasteve kur lopët sëmuren, për herë të parë mund të shërohen me sukses, por vetëm duke vepruar shpejt.

**Paisjet e testit dhe testin e lëngshëm mund t’i gjeni tek Austria Prämix, në adresën Gjokaj-Vorë, km.12, AL-1051, Tiranë, me numër celulari 0684026311. Këshilltarët e Austria Prämix në këtë fushë janë në dispozicion për informacion të mëtejshëm.**